

Procesverbal

Nga Mbledhja V (e pestë) e rregullt për vitin 2025 e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë: 30.05.2025

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e pestë të rregullt; dhe
3. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje kryetar, kolegë delegatë, përfaqësues i OSBE-së dhe të pranishëm të tjerë! Mirë se keni ardhë në mbledhjen e pestë të rregullt të KPF-së për vitin 2025! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë. I kemi tri pika të rendit të ditës dhe pesë pika të rendit të ditës të parapara për seancë. Nëse keni diçka rreth rendit të ditës së KPF-së, mund ta merrni fjalën! Në qoftë se jo, atëherë kush është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Fillojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro miratimit të procesverbalit? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë pikën e parë. Atëherë, vazhdojmë te pika e dytë: Shqyrtimi i materialit për seancën e pestë. Kalojmë te pika e dytë e paraprë: Propozim-vendimi për miratimin e nismës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar dhe fillimin e procedurave për binjakëzim ndërmjet Komunës së Dragashit dhe Komunës Purkesdorf – Austri. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë pikën e dytë. Vazhdojmë te pika e tretë: Propozim-vendimi për miratimin e nismës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar dhe fillimin e procedurave për binjakëzim ndërmjet Komunës së Dragashit dhe Komunës së Mavrovës-Rostushës, Maqedonia e Veriut. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro pikës së tretë? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, 1 kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe pikën e tretë. Vazhdojmë te pika e katërt: Propozim-vendim për anulimin e Vendimit për publikimin e listave të pronave të paluajtshme të Komunës (Lista e Përgjithshme dhe e Veçantë) 01Nr.060/01-5357-3/25 i datës 08.04.2025. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 3 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, kalon edhe kjo pikë. Atëherë, vazhdojmë me pikën e tretë të KPF-së, pikën eventuale. A do dikush me e marrë fjalën në pikën eventuale? A do me e marrë fjalën dikush? Në qoftë se jo, atëherë e mbyllim këtë KPF! Ju faleminderit!